

Mbi Auditimin Ushtruar në Agjencinë Rajonale të Mjedisit, Qarku, Tiranë,

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Agjencinë Rajonale të Mjedisit, Qarku Tiranë, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën nga data 01.07.2013 deri 31.12.2013, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 60 datë 16.06.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 153/9 datë 16.06.2014, dërguar Zj. Sonila Pashaj, Drejtore e Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Qarku Tiranë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Në zbatim të nenit 46, pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit në MM, të hartojë regjistrin e lejeve mjedisore ku të regjistrohen të gjitha lejet mjedisore dhe kategoritë e tyre, në të cilat të pasqyrohen ndryshimet apo modifikimet e lejeve të miratuara, dhe masat e vendosura nga Inspektorati i Mjedisit ndaj veprimtarisë të pajisur me leje, i cili të përdoret nga DRM në qarqe.

II. Për Drejtorinë Rajonale të Mjedisit:

1. DRM të specifikojë kushtet konkrete që duhen vendosur në lejen e mjedisit të Tipit C, konkretisht sipas natyrës së aktivitetit apo projektit si gjatë fazës së ndërtimit ashtu edhe asaj të shfrytëzimit, si dhe kushtet e shkarkimeve në mjedis, gjë që do të shërbejë edhe për përfitimin e të dhënave për hartimin e regjistrit kombëtar të ndotësve në nivel qarqe.

2. DRM Tiranë, në zbatim të nenit 13 të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të kryejë kqyrjen e vendit ku do të zhvillohet projekti në prani të specialistit që ka përgatitur dokumentacionin teknik (raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis), si dhe përfaqësuesit e qeverisjes vendore dhe të komunitetit ku është menduar të zhvillohet projekti.

3. Në lejet e Tipit C, DRM të bëjë një analizë e hollësishme raporteve të VNM-së, të paraqitur nga subjektet, bazuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.11.2009, “Për metodologjinë e vlerësimit të raportit të VNM-së” si dhe të plotësojë shtojcat e këtij udhëzimi të cilat të jenë pjesë e dokumentacionit të dosjes dhe të arkivohen së bashku me dokumentet e tjera të miratimit të ushtrimit të veprimtarisë apo projektit të propozuar.

4. Në lejet e tipit C, DRM të përcaktojë sipërfaqet e gjelbërta dhe llojin e tyre të shprehura në metër katror, si dhe të dhëna të tjera të domosdoshme që bëjnë të mundur minimizimin e efekteve negative mbi mjedisin dhe shëndetin e komunitetit ku aplikohen këto veprimtari.

5. DRM Tiranë, në zbatim të nenit 46, pika 2 e ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, t’i sigurojë publikut mundësinë për të marrë informacionin mjedisor që ajo disponon, si dhe të kryejë informimin publicitar për detyrimin ligjor që kanë subjektet për tu pajisur me dokument mjedisor.

6. Dosjet e mjedisit, të hartohen dhe të ruhen të plota si dhe të përditësohen për çdo subjekt, në mënyrë që kontrollet e kryera nga inspektorët e mjedisit të jenë të diktura nga problematika e veçantë, të mos kryhen si kontrolle rutinë të cilat rrezikojnë të mos nxjerrin në pah problemet e vërteta dhe nuk ndikojnë realisht në ruajtjen apo aty ku është e nevojshme përmirësimin e gjendjes së mjedisit.

7. Të informojë në mënyrë periodike dhe të detyrojë subjektet që të dorëzojnë rregullisht raportet e vetëmonitorimit në të cilat të pasqyrohen analizat specifike të kryera, sipas të gjitha kushteve të vendosura në lejet përkatëse mjedisore.

8. DRM Tiranë të punojë në drejtim të grumbullimit të informacionit të saktë dhe të përditësuar në lidhje me numrin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në qarkun e Tiranës për ato subjekte që disponojnë Leje të grupit III 1. C, të ndara sipas aktivitetit e veprimtarisë që ushtrojnë.

9. DRM Tiranë, në bashkëpunim me Inspektoratin e Mjedisit të hartojë një raport vjetor ku të paraqitet gjendja e mjedisit për Qarkun e Tiranës, bazuar në kontrollet mbi gjendjen e mjedisit të kryera nga inspektorët për vitin 2013 si dhe vitet në vazhdim.

Për Inspektoratin e Mjedisit:

1. Inspektorati i Mjedisit të fillojë krijimin e dosjeve mjedisore të subjekteve të pajisur me dokumentacion mjedisor që ushtrojnë aktivitet në qarkun e Tiranës në zbatim të Rregullores nr. 3, datë 10.09.2010 “Për krijimin dhe administrimin e dosjes mjedisore, si dhe rregullat e hollësishme për formën dhe përmbajtjen e saj”, të miratuar me Urdhrin e Ministrit nr. 730, datë 10.09.2010.

2. Në zbatim të nenit 69 “Kundërvajtjet”, pika 1/h, ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të gjobisë ato subjekte të cilat nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në njoftimin e pezullimit, brenda afatit, sipas përcaktimit në nenin 66 të këtij ligji, si dhe ato subjekte që ushtrojnë aktivitetin e tyre pa dokument mjedisor sipas sanksioneve të parashikuara në nenin 29, pika 1/a dhe 2, ligji nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” duke i trajtuar në mënyrë të barabartë.

3. Në akt kontrollet apo akt verifikimet e mbajtura gjatë inspektimeve të kryera, të lërë detyra specifike bazuar në aktivitetin e problematikën e subjektit si dhe të mbështetura në kushtet e lejes mjedisore dhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, trajtuar në faqet 22 - 28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

4. Inspektorati i Mjedisit të kryejë kontrolle të përsëritshme mbi gjendjen e mjedisit në qarkun e Tiranës në lidhje me ndotjen e ajrit në qytet, ndotjen akustike, shfrytëzimin pa kriter të lumenjve nga subjekte të ndryshme, ndotjen nga mbetjet urbane, inerte apo të vëllimshme, si dhe vendgrumbullimet e tyre, gjendjen e sistemit të kanalizimeve, etj.

5. Inspektorati i Mjedisit të hartojë plane mujore e vjetore të hartuara për inspektimin e kontrollin e vazhdueshëm dhe në mënyrë periodike të gjendjes së mjedisit për të gjithë treguesit mjedisorë, të miratuara më parë nga organet përkatëse në MM.

6. Në zbatim të nenit 69 “Kundërvajtjet”, pika 1/dh, ligji nr. 10431, datë 09.06.2011”Për mbrojtjen e mjedisit”, të vendosi sanksione ndaj subjekteve të cilat kryejnë monitorimin e mjedisit dhe nuk plotësojnë kërkesat për minimizimin e ndërhyrjes mbi përdorimin e tokës, pas kryerjes së veprimtarisë dhe për rikthimin e tokës në gjendjen e saj të mëparshme, sipas përcaktimit në nenin 43 të këtij ligji.

B. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37, të ligjit 7961 datë 12.07.1995, i ndryshuar, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, dhe në kontratën kolektive të punës, i kërkojmë Ministrisë së Mjedisit, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me paralajmërim për pushim nga detyra”, për:

1. ■■■■■ me detyrë Inspektor Pyjesh, pranë Inspektoratit të Mjedisit;

- Për mos krijimin e dosjes mjedisore të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në qarkun e Tiranës në përputhje me Rregulloren Nr. 3, datë 10.09.2010 “Për krijimin dhe administrimin e dosjes mjedisore, si dhe rregullat e hollësishme për formën dhe përmbajtjen e saj” e miratuar me Urdhrin e Ministrit nr. 730, datë 10.09.2010. Duke mos disponuar dosjen mjedisore të subjektit, kontrollet e kryera nga inspektorët e mjedisit për një subjekt të caktuar nuk janë të diktuar nga problematika e veçantë e subjektit, por kryhen si kontrolle rutinë të cilat nuk nxjerrin në pah problemet e vërteta dhe nuk ndikojnë realisht në ruajtjen apo aty ku është e nevojshme përmirësimin e gjendjes së mjedisit.

- Nga konstatimi i shkeljeve në terren ka prodhuar akte administrative absolutisht të pavlefshme sepse ka përdorur referenca ligjore të gabuara si ligji nr. 9890, datë 20.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8934, datë 05.09.2002, neni 2, pika 2/ç. Ky ligj nuk ekziston. Referenca e saktë ligjore për periudhën e audituar është ligji nr. 9983, datë 08.09.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8934, datë 05.09.2002”, neni 2, pika 2/ç. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për Kundravajtjet Administrative”, neni 19, pika 1/ç dhe si të tilla janë akte administrative absolutisht të pavlefshme, bazuar në Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, neni 107, pika 2/ç/dh dhe neni 116 pika “c”, sepse mund të bëhen shkak për mosnjohje nga Gjykata për nxjerrjen e titullit ekzekutiv ose ankimit në gjykatë të kundërvajtësve.

-Për subjektet që kanë ushtruar aktivitet pa leje mjedisore të veprimtarive që ndotin e dëmtojnë mjedisin, klasifikuar shkelje sipas ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, neni 82 pika 2/g, është vendosur masa e pezullimit të aktivitetit, ndërkohë që krahas masës së pezullimit që është masë plotësuese, inspektorët duhet të kishin aplikuar dënim administrativ. Masa e pezullimit nuk mund të aplikohet e vetme, kjo masë është shoqëruese e masës së

ndëshkimit me gjobë, sipas përcaktimit në nenin 29, pika 1/a dhe pika 3 e ligjit nr. 10 448, datë 14.07.2011, “Për lejet e mjedisit”.

- Për mosndjekje në vazhdimësi dhe mos kryerjen e kontrolleve periodike në subjekte që rezultojnë pa dokumentacion mjedisor gjë që bën të pamundur të vërtetohet nëse subjekti është pajisur me të si dhe mos kryerjen e rikontrollit të detyrave të lëna gjatë inspektimeve të mëparshme.

- Për trajtimin jo njëloj të subjekteve, për të cilët koha e lënë në dispozicion për tu pajisur me dokumentacion mjedisor nuk është e njëjtë në të gjitha rastet.

2. z. [REDAKTUAR] me detyrë Inspektor Mjedisi, pranë Inspektoratit të Mjedisit;

3. z. [REDAKTUAR] me detyrë Specialist pranë DRM, Tiranë;

4. z. [REDAKTUAR] me detyrë Inspektor Mjedisi, pranë Inspektoratit të Mjedisit;

5. z. [REDAKTUAR] me detyrë Inspektor Pyjesh, pranë Inspektoratit të Mjedisit;

6. z. [REDAKTUAR] me detyrë Inspektor Mjedisi, pranë Inspektoratit të Mjedisit;

7. z. [REDAKTUAR] me detyrë Inspektor Mjedisi, pranë Inspektoratit të Mjedisit;

8. z. [REDAKTUAR] me detyrë Inspektor Pyjesh, pranë Inspektoratit të Mjedisit;

- Nga konstatimi i shkeljeve në terren kanë prodhuar akte administrative absolutisht të pavlefshme sepse kanë përdorur referenca ligjore të gabuara si ligji nr. 9890, datë 20.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8934, datë 05.09.2002, neni 2, pika 2/ç. Ky ligj nuk ekziston. Referenca e saktë ligjore për periudhën e audituar është ligji nr. 9983, datë 08.09.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8934, datë 05.09.2002”, neni 2, pika 2/ç. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për Kundravajtjet Administrative”, neni 19, pika 1/ç dhe si të tilla janë akte administrative absolutisht të pavlefshme, bazuar në Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, neni 107, pika 2/ç/dh dhe neni 116 pika “c”, sepse mund të bëhen shkak për mosnjohje nga Gjykata për nxjerrjen e titullit ekzekutiv ose ankimit në gjykatë të kundërvajtësve.

-Për subjektet që kanë ushtruar aktivitet pa leje mjedisore të veprimtarive që ndotin e dëmtojnë mjedisin, klasifikuar shkelje sipas ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, neni 82 pika 2/g, është vendosur masa e pezullimit të aktivitetit, ndërkohë që krahas masës së pezullimit që është masë plotësuese, inspektorët duhet të kishin aplikuar dënim administrativ, sipas përcaktimeve në nenin 29, pika 1/a dhe pika 3 e ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”.

- Për papërgjegjshmëri dhe nivel të ulët profesionalizmi në plotësimin e aktkontrolleve dhe aktverifikimeve të cilat rezultojnë me gabime si dhe në lënien e detyrave të cilat nuk janë të bazuara në lejen mjedisore përkatëse dhe në ligj.

- Për trajtimin jo njëloj të subjekteve, për të cilët koha e lënë në dispozicion për tu pajisur me dokumentacion mjedisor nuk është e njëjtë në të gjitha rastet.

Shënim: Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin e auditimit janë konstatuar përgjegjësi të natyrës drejtuese dhe menaxhuese dhe zbatuese të legjit,

Për:

1. z. [REDAKTUAR] në cilësinë e Kryetarit të Agjencisë Rajonale të Mjedisit;

2. z. [REDAKTUAR] në cilësinë e Specialistit të VNM pranë ARM-së;

3. z. [REDAKTUAR] në cilësinë e inspektorit të mjedisit;

4. z. [REDAKTUAR] në cilësinë e Inspektorit të Mjedisit;

5. z. [REDAKTUAR] në cilësinë e Inspektorit të Mjedisit;

6. zj. [REDAKTUAR] në cilësinë e Inspektorit të Mjedisit;

7. z. [REDACTED] në cilësinë e Inspektorit të Mjedisit, të cilat mund të vlerësoheshin me masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra”. Nuk rekomandojmë masë disiplinore për personat e sipërpërmendur duke e konsideruar masën të ezauruar, pasi nuk janë në marrëdhënie pune me këtë subjekt.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Mimoza Lloji dhe Keida Muça, më tej u shqyrtua nga k/auditues Bashkim Arizaj, Drejtori i Departamentit Xhafer Xhorxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Grupi i auditimit
Mimoza Lloji
Keida Muça
Almen Alemi

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R